



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Tiranë, më datë 18.09.2020

Nr. 890 Prot.

VENDIM

Nr. 333, datë 14.09.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 14.09.2020,

VENDOSI:

- Miratimin e projektit të zbatimit P01 "Restaurimi i peisazhit historik urban të Lagjes Goricë" dhe P03 "Rehabilitimi i shtegut të Kalasë së Goricës dhe krijimi i potencialeve turitike pranë monumentit" pjesë e projektit "TASK 5 – Koncepti paraprak, udhëzimet dhe Preventivi paraprak për projekt Investimet e përzgjedhura në Berat, hartuar nga "Atelier 4" dhe "KEIOS", me aplikues FSHZH;
Projekti të plotësohet/rishikohet si në vijim:
 - Të plotësohet projekti me detajet teknike, prerjen tërthore dhe relacion përkatës për sistemin e kullimit të ujrave;
 - Çezma e gizës të trajtohet si ekzistueset;
 - Të rishikohet trajtimi i fasadës së objektit G 118, duke ruajtur origjinalitetin e tij me ngjyrën e sfumuar;
 - Të rishikohet mbushja me zhavorr e shtegut për shkak të problematikave që mund të shfaqen në sezonin e reshjeve;
 - Të merret parasysh mbrojtja lumore në lumin e Osumit dhe të rishikohet trajtimi i ndarjes së rrugës së këmbësorëve me atë automobilistike;
 - Të restaurohen dyert ose të zëvendësohen pjesërisht në rastet e nevojshme;
 - Të plotësohen fletët grafike me detaje teknike (arkitektonike dhe konstruktive);
 - Nëse parashikohen ndërhyrje që kanë nevojë për germim (për pjesën e shtegut), duhet parashikuar hartimi i raportit arkeologjik;
 - Për çdo objekt që është subjekt i ndërhyrjeve duhet të paraqitet projekti i plotë i restaurimit;
- Projekti do të dërgohet pranë UNESCO-s për mendim;
- Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
- Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;

